



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 244 183, E-mail: rektorati@uni-pr.edu, www.uni-pr.edu

ZYRA PËR KËRKIME DHE
PROJEKTE TË SPONZORIZUARA

Rritja e veprimtarisë kërkimore-shkencore, artistike dhe sportive, është një nga objektivat e Planit Strategjik (2020-2022) të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Përmes nxitjes së aktiviteteve kërkimore-shkencore, artistike dhe sportive, UP-së ka si qëllim të mbështesë hulumtuesit e të gjitha njësive e akademike. Për më tepër, synohet të rritet bashkëpunimi në mes grupeve të ndryshme kërkimore-shkencore, artistike dhe sportive me pjesëmarrje edhe të studentëve, si dhe fuqizimi i instituteve kërkimore në UP-se. Bazuar në Planin Strategjik të UP-së (2020-2022), si dhe në Rregulloren (Nr.3/879 dt. 11.12.2020) për Financimin e Veprimtarisë Kërkimore-Shkencore, Artistike dhe Sportive, UP-së, shpall:

THIRRJE

për aplikim në financimin e projekteve shkencore

Të drejtë aplikimi për projekte shkencore kanë të gjitha grupet kërkimore dhe stafi i UP-së (stafi akademik me marrëdhënie të rregullt pune) dhe studentët e doktoratës që identifikohen me njësinë akademike. Ekipi hulumtues duhet të përbëhet nga të paktën tre (3) hulumtues me gradën doktor shkence (njeri prej tyre të jetë udhëheqës i projektit), anëtarët tjerë mund të jenë studentë të doktoratës, masterit / studimeve themelore 5-6 vjeçare (viti i 5-6 të studimeve).

E gjithë puna e kërkimit shkencor, artistik dhe sportiv që parashihet të realizohet në kuadër të këtyre projekteve duhet të kryhet brenda kampusit të UP-së ose në terren, nga stafi akademik dhe studentët e angazhuar në projekt. Rezultatet e çdo projekti duhet të prezantohen para një auditoriumi më të gjerë, me te cilat dëshmohet se ndërlihet me qëllimin për hulumtim dhe zhvillim (Research and Development). Po ashtu rezultatet e arritura të projektit duhet të publikohen me të paktën një punim, i cili duhet të publikohet në revistë shkencore kredibile të indeksuar në platformat përkatëse (sipas rregulloreve në fuqi) ose me një ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare artistike dhe sportive.

Projekti duhet të jetë inovativ, të shtjelloj ide të reja, të cilat nuk janë realizuar më parë në UP-së ose ndonjë institucion tjetër, si dhe të jetë në harmoni me prioritetet nacionale dhe me gjerë, si dhe me dokumentet strategjike të UP-së. Përparësi në financim do ti jepet projekteve, të cilat implementimi do të realizohet përmes instituteve kërkimore (me qëllim të fuqizimit të instituteve), fushave ndërdisiplinore me pjesëmarrje nga anëtar te stafit akademik të dy e më

shumë njësive akademike, si dhe projekteve të cilat kanë mbështetje nga ndonjë institucion kërkimor ndërkombëtar.

Shuma e përgjithshme për financimin e projekteve shkencore në UP-së për vitin 2022, është **77,440.00**.

Vlera maksimale e projektit për të cilën mund të aplikohet është deri në **8,000.00 €**.

Kohëzgjatja maksimale e projektit është 12 muaj.

Aplikimi duhet bëhet në Zyrën për Kërkime dhe Projekte të Sponzorizuara (ZKSP) në formë elektronike (zkps@uni-pr.edu), dhe me dokumentacionin origjinal si kopje fizike.

Kërkesës për aplikim duhet ti bashkëngjiten:

- Formulari për aplikim, i plotësuar dhe nënshkruar nga bartësi i projektit;
- Letra mbështetëse nga udhëheqësi njësisë akademike/instituti/departamentit/katedrës (nënshkruar dhe vulosur);
- Nëse ka, letra mbështetëse nga institucioni kërkimor ndërkombëtar (CV e ekspertit pjesëmarrës në projekt);
- CV e bartësit dhe hulumtuesve të angazhuar në projekt.

Afati për konkurrim do të jetë deri më datën **30.05.2022**. Nuk do të merren parasysh projektet me dokumentacion të pakompletuar dhe të dorëzuara pas afatit.

Projekt-propozimi do të vlerësohet me pike (maksimum 50 pike) dhe pragu për vlerësim kualifikues do të jetë minimum 30 pike. Ndërsa, çdo kriter vlerësues do të poentohet nga 1-5 pike.

Projekt-propozimet do të vlerësohen sipas kriterëve të pacaktuara më poshtë:

1. Rëndësia e projekt-propozimit	Pikët
1.1 Lidhshmëria e projekt-propozimit me objektivat dhe prioritetet e thirrjes. A janë rezultatet e pritura të projektit në përputhje me prioritetet e përcaktuara në thirrje?	5
1.2 Lidhshmëria e projekt-propozimit me dokumentet strategjike të UP-së, dokumentet nacionale dhe më gjerë. Cilat nevoja dhe kufizime adreson projekti në nivel të UP-së, vendit dhe rajonit bazuar në strategjitë dhe iniciativat në fusha relevante?	5
1.3 Vlerat e veçanta të projekt-propozimit (inovacion, praktikat më të mira, interdisciplinarteti) dhe promovimi i mbrojtjes së mjedisit, promovimi i barazisë gjinore, pjesëmarrja e personave me aftësi të veçanta.	5
2. Dizajni i projekt-propozimit	
2.1 Koherenca e dizajnit të projekt-propozimit. A janë të arritshme rezultatet e pritura të projekt-propozimit? A shpjegohet në mënyrë logjike pritshmëria e rezultateve të pritura?	5
2.2 A implementohet projekt-propozimi përmes instituteve kërkimore?	5

2.3 Kapaciteti i ekipit hulumtues dhe kapacitetet e tyre teknike (laboratorë, pajisjet e ndryshme, metodologjia), si dhe përmbajtja e publikimeve të tyre në raport me tematiken e projekt-propozimit.	5
2.4 Përbërja e ekipit hulumtues, partnerët pjesëmarrës në projekt (nga UP dhe ndërkombëtar); numri i studentëve të inkuadruar në projekt; përshkrimi i rolit të secilit anëtar të ekipit pjesëmarrës në projekt.	5
2.6 Aktivitetet a janë të realizueshme (bazuar në kapacitete që ka UP-se); përshkrimi i planit të punës (afatet kohore) dhe atij financiar (buxheti); aktivitetet e planifikuara a e mundësojnë arritshmërin e rezultateve të pritshme.	5
2.7 Ndikimi i pritur i rezultateve të projektit në UP-se dhe shoqërinë; qëndrueshmëria e projektit, si do të vazhdojnë aktivitetet e filluara me këtë projekt pas përfundimit të implementimit të projektit.	5
2.8 Plani për shpërndarjen e rezultateve (organizimi dhe pjesëmarrja ne ngjarje shkencore, sportive dhe artistike, si dhe publikimet shkencore).	5
Totali i pikëve	